

SHQIPJA NËN EFEKTIN E GLOBALIZIMIT BRENDAETNIK DHE NDËRETNIK

Behar HOXHAI, Universiteti i Tiranës
hoxhajbehar@gmail.com

Abstrakt

Ky artikull analizon statusin e gjuhës shqipe nën ndikimin e globalizimit brenda-etnik dhe ndëretnik, si pjesë e proceseve më të gjera të globalizimit botëror. Në këtë kuadër, shqipja përballlet me dy sfida kryesore: (1) trysnia nga huazimet leksikore prej gjuhëve të huaja; dhe (2) globalizimi brenda-etnik, që lidhet me zhvendosjen dhe përzierjen e komuniteteve shqipfolëse në zona të ndryshme gjeografike dhe kulturore. Pas viteve 1990, me ndryshimet politike, shoqërore dhe ekonomike, ndikimi mbi zhvillimin e shqipes është bërë më i dukshëm, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe enklava të tjera shqiptare. Nga një realitet i mbyllur dhe i centralizuar, siç ishte Shqipëria para viteve '90, shoqëria kaloi drejt një hapjeje që solli afrimin e individëve dhe komuniteteve shqiptare përmes migrimit dhe komunikimit më të shpejtë. Këto lëvizje kanë ndikuar në përdorimin e shqipes - në standardin e saj, në kontaktin me dialektet, si dhe në prirjen për të marrë elemente nga gjuhë të tjera. Studimi shqyrton mënyrën se si këto ndikime po e transformojnë përdorimin publik të shqipes dhe rolin e saj si gjuhë kombëtare, duke theksuar sfidat bashkëkohore për ruajtjen dhe përshtatjen e saj.

Fjalë çelës: gjuha shqipe, globalizim brendaetnik, globalizim ndëretnik, trysni, zhvillim.

Albanian Language under the effect of Intra-Ethnic and Inter-Ethnic Globalization

Abstract

This article analyzes the status of the Albanian language under the influence of intra-ethnic and inter-ethnic globalization, within the broader framework of global change. In this context, Albanian faces two major challenges: (1) pressure from lexical borrowings from other languages; and (2) intra-ethnic globalization, related to the movement and merging of Albanian-speaking communities across various geographic and cultural regions. Since the 1990s, following major political, social, and economic shifts, the effects on Albanian's development have become increasingly evident—not only in Albania but also in Kosovo, North Macedonia, Montenegro, and other Albanian-speaking enclaves. Transitioning from an isolated, centralized society to an open and mobile one brought communities closer through migration and faster communication. These shifts have influenced how Albanian is used—its standard form, its interaction with dialects, and its tendency to absorb elements from other languages. This study explores how such influences are transforming Albanian's public usage and its function as a national language, while highlighting the contemporary challenges of preserving and adapting it in a globalized context.

Keywords: Albanian language, effect, intra-ethnic globalization, inter-ethnic globalization.

Hyrje

Gjuha shqipe gjendet përballë dy sfidave kryesore në kontekstin e globalizimit botëror, siç janë: 1. Shqipja përballë trysnisë së huazimeve nga gjuhë të tjera dhe 2. Globalizimi i shqipes brenda-etnike, që lidhet me lëvizjen, zhvendosjen e popullsisë. Pas ndryshimeve politike, shoqërore, ekonomike etj. gjatë viteve '90, vërehen edhe pasojat në zhvillimet e gjuhës shqipe, në Shqipërinë politike, por edhe në shtetet ku flitet shqip, si në Kosovë, në Maqedoni të Veriut, në Mal të Zi e në krahina të tjera që përbëjnë enklava shqiptarësh. Nga një shoqëri politikisht e bllokuar, e izoluar, siç ishte Shqipëria para viteve '90, nëpërmjet lëvizjes së lirë të njerëzve, hapjes ndaj botës, ndërtimit të një infrastrukture të re, shkurtohet edhe distanca dhe koha e bashkimit të njerëzve, për pasojë edhe e komunikimit të tyre. Me këtë rast edhe gjuha ndikohet nga këto zhvillime, duke ndryshuar kështu edhe paraqitja e përdorimit të saj, si e gjuhës standarde, por çfarë është më e rëndësishmja e gjuhës kombëtare. Prej shkaqeve që kanë çuar drejt këtyre zhvillimeve së pari është lëvizja e popullsisë brenda Shqipërisë politike pas '90-ës drejt qendrave urbane dhe, së dyti, hapja e kufijve politikë, gjë që bëri të mundur zgjerimin e mendësisë së komunikimit brenda-etnik. Pra, ra "perdja e hekurt" që ndante shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve politikë të Shqipërisë. Ideja është që nga një shoqëri politikisht e bllokuar, e izoluar, nëpërmjet lëvizjes së lirë të njerëzve, hapjes, ndërtimit të rrugëve, gjetjes së mjeteve të reja të komunikimit, siç është zhvillimi i teknologjisë, kemi një situatë në të cilën shkurtohet distanca dhe koha e bashkimit të njerëzve, për pasojë edhe e komunikimit. Ndërkohë, pas vitit '90 vihet re se "arkipelagët" futen në hullinë e një urbanizimi të ri, si pasojë edhe gjuha futet në një etapë tjetër të zhvillimit të saj. Gjithashtu, Shqipëria politike çliroi popullsitë në funksion të një tjetër jetese, bashkëveprimi dhe drejt një komunikimi ndëretnik të vrullshëm, si asnjëherë tjetër para viteve '90. Siç pohon Paçarrizi (2022, f. 280): "Shqipja dhe shqiptarët nuk janë ata/ato të para 50 vjetësh. Gjatë kësaj kohe kanë ndryshu njerëzit dhe rrethanat: 1. po ndodh komunikimi intensiv dhe i papenguar ndërmjet folësve të shqipes me origjinë të ndryshme dialektore, në situata formale dhe joformale; 2. ka ndodhë relativizimi i pengesave dhe orientimeve ideologjike; 3. ka ndodhë qasja e papenguar në shkencën moderne dhe po mbizotëron deskriptivizmi; 4. po ndodh qasja dhe prania joselektive në medime si gazetaria e letërsia. 5. ka medime alternative - radio, tv, gazeta, portali, libri".

Gjendja e gjuhës shqipe në trojet shqiptare

Si paraqitet gjendja e gjuhës shqipe në trojet shqiptare? Në Shqipëri, pas viteve '90 gjuha shqipe po "çlirohet" gradualisht prej "gjuhës së drunjtë" e cila, gjatë periudhës komuniste, në shumë aspekte të ligjëritimit politik e publik, shprehte një model perceptimi të shqiptarëve brenda kornizës së dogmës ideologjike komuniste (Rrokaj dhe Hoxhaj, 2024c, f. 31). Dihet tashmë debati për standardin e gjuhës shqipe, për rregullat që u vendosën në Kongresin e Drejtshkrimit në vitin 1972, për ngritjen në normë të njërit dialekt, për prestigjin e njërit apo tjetrit dialekt. Megjithatë, ecuria e zbatimit të standardit nuk vështirësohet kaq shumë nga ndërhyrja e dialektit sesa nga vështirësitë, që ka çdo standard në vetvete (Likaj, 2022, f. 45). Ekzistojnë edhe paragjykime të tipit që një gjuhë (qoftë edhe standarde – B. H.) është më e përparuar apo më e zhvilluar se dialektet, por çdo dialekt ka sisteme komplekse fonologjike dhe sintaksore si çdo gjuhë tjetër (Graffi dhe Scalise, 2002, f. 48-49). Po sipas Graffi-t dhe Scalise-s (2002, f. 48), një dialekt është një sistem gjuhësor me të gjitha funksionet e veta në çdo aspekt, ai nuk është një kod dytësor, i reduktuar, i papërsosur. Siç shprehet prof. A. Doka, po të pranojmë se lidhja që bashkon shenjuesin me të shënuarin është arbitrare, d.m.th. e pamotivueshme me logjikë, atëherë nuk

kemi pse kërkojmë një shënjes "më të mirë" ose më "të keq" për të njëjtin të shënuar. Për këtë arsye ndryshimi gjuhësor nuk ka karakter evolutiv dhe as devolutiv, çka e bën gjuhën dukuri shoqërore të një lloji të veçantë (Doka, 2022, f. 220). Gjithsesi, gjuha ka rrjedhat e veta të përdorimit ose edhe të ndryshimit. Thelbësore është që ka dalë nga ajo periudhë e "gjuhës së drunjtë", e asaj periudhe të direktivave nga lart.

Në Kosovë, pushteti serb historikisht kishte synim për të asgjësuar "çdo gjë shqiptare". Në të vërtetë, "krimi dhe gjenocidi i planifikuar, i përgatitur 'shkencërisht' dhe i zbatuar profesionalisht e institucionalisht", ka filluar të zbatohet në Kosovë sistematikisht pas Luftës së Parë Botërore për të arritur kulmin në regjimin serb të Sllobodan Millosheviçit. Së këndejmi, "promovimi i gjuhës së urrejtjes ndaj popullit shqiptar", veçanërisht gjatë viteve të tridhjetë e të nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, nuk mund të shpinte tjetër veçse në mohimin e së drejtës për ekzistencë të shqiptarëve (Mekaj, 2020). Kështu, edhe gjuha shqipe, si çdo gjë ekzistenciale shqiptare në Kosovë, ishte në rrezik. Megjithatë, falë vizionit largpamës e tolerant, u vendos që të organizohej në Prishtinë Konsulta gjuhësore në vitin 1968, si një mesazh të qartë për këdo, që ka veç një komb, ka veç një gjuhë dhe kjo është gjuha shqipe. Me miratimin e projektit të rregullave të drejtshkrimit në këtë Konsultë, shqipja letrare i kapërceu kufijtë e një koineje lokale për t'u shndërruar në një koine gjithëkombëtare (Doka, 2002, f. 216). Ndërkohë, në ditët e sotme, ne i gëzohemi faktit se Kosova është shtet i pavarur, me institucionet e saj dhe me gjuhën zyrtare, atë shqipe (Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj [Kushtetua e Republikës së Kosovës, neni 5, 2008]). Për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut situata ka qenë dhe është më e ndërlikuar, pavarësisht së drejtës universale për përdorimin e gjuhës. Sipas ish-ambasadorit James Pardew, një nga problemet kryesore të Marrëveshjes së Ohrit ka qenë zyrtarizimi i gjuhës shqipe në tërë territorin e Maqedonisë (Rrokaj, 2024b, f. 117; Sinani, 2016). Megjithatë, vetë shqiptarët e Maqedonisë së Veriut standardin e shqipes e çmojnë si një nga vlerat më të mëdha gjithëkombëtare dhe prandaj standardi nuk u kontestua asnjëherë as nga gjuhëtarët, as nga intelektualët dhe as nga masat e gjera, jo sepse e përvetësojnë dhe e zbatojnë lehtë apo sepse e idealizojnë, por sepse janë të vetëdijshëm për rolin e tij gjuhësor dhe jashtëgjuhësor (Sulejmani, 2022, f. 211). Edhe në Mal të Zi, gjuha shqipe është gjuhë në përdorim zyrtar, e njohur zyrtarisht si gjuhë minoritare (në Podgoricë, Ulqin, Tivar, Plavë, Rozhajë dhe Tuz).

Efekti i globalizimit brendaetnik dhe ndëretnik

Pa dyshim që gjendja e shqipes në trojet shqiptare dy dekadat e fundit, edhe nga pikëpamja politike, paraqitet më e favorshme se asnjëherë tjetër. Në tri shtete ka pasur dhe ka drejtues të lartë (kryeministra, kryetarë kuvendesh, përveç ministrave të ndryshëm). Por, çfarë është me e rëndësishmja: lëvizja dhe komunikimi ndërmjet shqiptarëve ka qenë më intensiv se kurrë më parë. Jemi në një epokë të re, moderne, në qoftë se mund të themi kështu, së cilës i përgjigjet edhe një nevojë e re për gjuhën shqipe. Shqipja sot është gjuha e folësve të saj për nevoja e domene të ndryshme në hapësira shpesh të përbashkëta me gjuhë të tjera e në konkurrencë me to. Ritmet e zhvillimit të saj nëpër pjesë të ndryshme të bashkësisë kanë qenë të ndryshme, çka po ashtu ka lënë pasojë. Kjo mund të jetë me rëndësi për zhvillimet (Ismajli, 2022, f. 31). Modernizimi i gjuhës zakonisht është i lidhur me ndryshimet socio-kulturore dhe ekonomike-politike që ndodhin në kohëra të caktuara. Në këtë kuptim nuk bën përjashtim as rasti i gjuhës shqipe. Ndryshimet e tilla shoqërore dhe kulturore pas vitit 1990 kanë qenë mjaft dinamike gjithandej nëpër botë, por edhe në hapësirat shqipfolëse në Ballkan. Pa dyshim, këto

ndryshime kanë pasur dhe janë duke pasur ndikime në zhvillimet e shumta gjuhësore dhe sociolinguistike brenda gjuhës shqipe (Munishi, 2022, f. 225). Vetë ndryshimi gjeopolitik pas viteve '90 po krijon mundësi të reja lëvizjeje të njerëzve e bashkë me ta edhe të vetë gjuhës, e cila po del prej enklavave tradicionale, duke kapërcyer pengesat e dikurshme, që vinin nga izolimi i kufijve politikë e demografikë (Rrokaj, 2024c, f. 31-32). Brenda kufijve politikë lëvizja e lirë ka vënë gjithashtu në dyshim konceptet demografike klasike të të folmeve dhe të dialekteve, duke u orientuar drejt krijimit të një komunikimi folësish heterogjenë nga prurje enklavash të ndryshme, sidomos në qendrat e mëdha urbane (Rrokaj, 2024a, f. 75). Pavarësisht nga copëzimi në disa shtete, trysnia amnore ka çuar drejt bashkimit të të gjithë shqiptarëve brenda normës së natyrshme të gjuhës shqipe, si një të tërë, që përfshin standardin bashkë me dialektet apo çdo varietet tjetër të shqipes.

Gjuha shqipe përballë dy sfidave

Siç e thamë dhe në fillim, shqipja, në kuadrin e globalizimit, gjendet në radhë të parë përballë trysnisë së fjalëve të huaja. Kjo, për shkak se globalizimi lidhet me hapjen e shoqërisë shqiptare ndaj shoqërisë globale, me trysninë e gjuhëve të vendeve të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht me të cilat shqipja është në kontakt. Kjo trysni është më e spikatur në fazat e para të hapjes. Fjalët dhe strukturat e huaja "vërshojnë" nga të gjitha anët, saqë duket se po ia marrin frymën gjuhës. Por, hap pas hapi, folësit fillojnë e reagojnë me vetëdijen e vetëmbrojtjes gjuhësore; shtien në punë kujtesën e përbashkët për të kërkuar brenda gjuhës që përdorin gjegjëset e tyre dhe, vetëm kur bëhet i pamundur zëvendësimi, atëherë pranojnë t'i përdorin fjalët e huaja, duke ia nënshtruar sistemit të gjuhës amtare (Rrokaj, 2024c, f. 90). Ndërkaq, vihet re edhe një trysni e gjuhëve të tjera, në një pjesë të madhe të trojeve shqiptare dhe e politikave nacionaliste në këto vende. Kjo dukuri shkon krahas edhe me ndikimin e gjuhëve të tjera, kryesisht anglishtja, në gjuhën shqipe, sidomos tani në kohën e globalizimit. Megjithatë, nuk duhet ngatërruar zhvillimi i sotëm i shoqërisë drejt globalizimit me procesin objektiv a me prirjen drejt krijimit të gjuhëve letrare kombëtare ose ndërkombëtare, sepse gjuhët përmbajnë në thelb më shumë elemente të ndërgegjes a të shpirtit të njeriut a të popujve... Thirrja në emër të globalizimit nuk do të thotë "shkatërrim" i identitetit gjuhësor (Samara, 2005, f. 24).

Sfida tjetër, me të cilën përballlet shqipja, është globalizimi i shqipes brenda-etnike, që lidhet me lëvizjen, zhvendosjen e popullsisë pas ndryshimeve të vullshme të viteve '90. Në të vërtetë, unë do ta quaja, përveçse sfidë, edhe një rrethanë të favorshme për *gjithëshqipen*. Gjithë kjo lëvizje popullore nga një shtet në tjetrin do të çojë te zhvillime interesante për shqipen (me shpresë - pozitive). Tanimë "përplasen" të gjitha të folmet deri edhe tek idiolektet (besoj se dialektet klasike kanë hyrë në një etapë tjetër, në të cilën marrin rëndësi zhvillimet dhe ndarjet sociolinguistike sesa ato gjeografike-gjuhësore). Kjo prurje nga të gjitha hapësirat ku flitet shqip do të shkundë e do të përziejë të gjithë regjistrat gjuhësorë, që nga standardi e deri tek e folmja e çdo individ. Gjithë këto zhvillime i japin shqipes edhe një prej veçorive apo roleve kryesore që ka luajtur dhe luan sot e kësaj dite, siç është edhe karakteri përbashkues i strukturës së saj ndërmjet shqiptarëve të të gjitha trevave apo edhe më gjerë, në diasporë kudo në botë. Kjo do të thotë se shqipja ia ka dalë me sukses të ruajë e të zhvillojë një nga tiparet kryesore të saj: përbashkimin e të gjithë shqiptarëve në një komb.

Më sipër u fol për lehtësirat fizike të komunikimit gjuhësor, siç është heqja e barrierave kufitare e politike, ndërtimi i një infrastrukture të rrugore etj., por kemi edhe shumë fusha të jetës që i kanë shërbyer komunikimit gjuhësor brenda-etnik. Këtu mund të përmendim artin: muzika, filmi, teatri, humori, letërsia, piktura, fotografia etj. apo sporti. Për shembull, përveç lojtarëve që aktivizohen me

skuadra të sporteve të ndryshme si në Shqipëri, Kosovë apo Maqedoni të Veriut, kemi skuadrën kombëtare të futbollit, e cila në gjirin e vet ka pasur këto dy-tri dekada futbollistë nga të gjitha trojet shqiptare e më gjerë. Kemi Ligën Unike të basketbollit në të cilën marrin pjesë ekipe nga Shqipëria dhe Kosova, një nismë që duhet përgëzuar, por edhe duhet zbatuar jo vetëm në sporte të tjera apo në art e kulturë, por edhe në shumë fusha të tjera, siç është arsimit, ekonomia etj. Është e vërtetë që kemi një abetare që nga vitit 2012, por kjo duhet shtrirë në të gjitha lëndët. Gjithë ato marrëveshje ndërqeveritare duhen zbatuar, madje duhen inkurajuar të tjera të ngjashme.

Konkluzione

Pra, të gjithë këta faktorë të mësipërm mendoj se e futin shqipen në një hulli të re, në mënyrë që edhe përballjen me sfidat e një mijëvjeçari të ri ta kthejë në favorin e vet. Së pari, duke iu përgjigjur vërshimit të fjalëve të huaja me fjalë dhe ndërtime nga vetë brumi i shqipes. Së dyti, duke shfrytëzuar gjithë këtë potencial që mund të çlirojë vetë gjuha si pasojë e globalizimit brendaetnik.

Referenca

- Doka, A. (2022). Shqipja standarde mes jakobinizmit dhe liberalizmit gjuhësor. Në R. Ismajli (Red.), *Shqipja standarde sot – Konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit*. Prishtinë: ASHAK.
- Graffi, G., & Scalise, S. (2002). *Le lingue e il linguaggio – Introduzione alla linguistica*. Bologna: Il Mulino.
- Ismajli, R. (2022). Gjuha shqipe sot. Në R. Ismajli (Red.), *Shqipja standarde sot – Konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit*. Prishtinë: ASHAK.
- Likaj, E. (2022). Gjuha standarde dhe realitete gjuhësore. Në R. Ismajli (Red.), *Shqipja standarde sot – Konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit*. Prishtinë: ASHAK.
- Mekaj, G. (2020). Kosova gjatë viteve 1989–1999 (Pjesa e parë). Marrë nga <https://www.botasot.info/kultura/1365726/kosova-gjate-viteve-1989-1999-pjesa-e-pare/>
- Munishi, Sh. (2022). Mbi nevojën e modernizimit të gjuhës shqipe. Në R. Ismajli (Red.), *Shqipja standarde sot – Konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit*. Prishtinë: ASHAK.
- Paçarrizi, Rr. (2022). Standardizimi i shqipes si proces: Paskajorja dhe pjesorja e shkurtuar. Në R. Ismajli (Red.), *Shqipja standarde sot – Konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit*. Prishtinë: ASHAK.
- Rrokaj, Sh. (2024). Kahe zhvillimi të shqipes standarde pas viteve '90 dhe disa qasje epistemologjike rreth tyre. Në Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 5*. Tiranë: Graphic Line-01.
- Rrokaj, Sh. (2024). Ligji për gjuhët në Maqedoninë e Veriut dhe gjuha shqipe. Në Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 5*. Tiranë: Graphic Line-01.
- Rrokaj, Sh., & Hoxhaj, B. (2024). Lënda e gjuhës shqipe dhe standardi në shkollë. Në Rrokaj, Sh., *Çështje të gjuhës shqipe 5*. Tiranë: Graphic Line-01.
- Samara, M. (2005). *Histori e gjuhës letrare shqipe (shek. XV–XXI)*. Tiranë: SHBLU.
- Sinani, A. (2016). Zyrtarizimi i gjuhës shqipe në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. *Studime Historike*, 03–04, 235–263. Qendra e Studimeve Albanologjike.
- Sulejmani, B. (2022). Gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut: Shqipja standarde dhe statusi i pabarabartë i saj me maqedonishten. Në R. Ismajli (Red.), *Shqipja standarde sot – Konferencë shkencore me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit*. Prishtinë: ASHAK.